



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborní Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.619/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Adnan Konushevcí, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, vendosje e materialit zgjedhor në hapësire publike – trafo elektrike, për Zgjedhjet Lokale 2021, që janë mbajtur me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 18.10.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** e bazuar ankesa e Lidhja Demokratike e Kosovës-(LDK), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1,200.00 (nje mijë e dyqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët-vendosja e materialit zgjedhor në hapësire publike – trafo elektrike.

**II.** Detyrohet Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

Lidhja Demokratike e Kosovës-(LDK), ka parashtruar ankesë në PZAP A.nr.619/ ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 15.10.2021, me të cilën pretendon se në komunën e Podujevës me datë 15 tetor rreth orës 08:30, aktivistët e saj kanë vërejtur se kandidatja për Kuvendin Komunal të Podujevës nga radhët e Lëvizës Vetëvendosje – Sebastiana Vokri me numër 12 në listë, ka shpërndarë material zgjedhor (baner) në kundërshtim me nenin 33, pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kjo ngase e njëjta ka shpërndarë materialin zgjedhor në hapësirë të palejuar – trafo elektrike, siç vërehet edhe në dëshmitë e ofruar (foto si provë).

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankuesi ka bashkangjitur një fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

PZAP-i me datën 15.10.2021 e njoftoi subjektin politik LVV, me ankesën e parashtruar dhe kërkoi nga e njëjta që deri me datën 16.10.2021 të përgjigjet në ankesë. Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, të datës 16.10.2021, kanë theksuar se nuk është

kontestues fakti se në foto e cila iu është bashkangjitur ankesës vërehet posteri i kandidates nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Sebastiana Vokri.

Mirëpo, sipas përgjigjes në ankesë më datë 14.10.2021, me kërkesën e kandidates Sebastiana Vokri, i njëjti poster ishte zhvendosur nga një person me emrin Sabri Murati, duke e vendosur në oborrin e shtëpisë së tij, në ormanin elektrik.

Më tej në përgjigje theksojnë se deklarimi i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK, lidhur me kohën në të cilën e kanë vërejtur posterin e kandidates Sebastiana Vokri, konkretisht më 15.10.2021, rreth orës 8:30 është i pa qëndrueshëm.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur një fotografi nga vendi ku është larguar posteri, si dhe një fotografi nga komunikimi të cilin e ka bërë e kandidatja Sebastiana Vokri dhe Sabri Murati.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Subjekti Politik LDK, me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë PZAP A.nr. 619/2021 më datë 15.10.2021, me të cilën pretendon se në Komunën e Podujevës, me datë 15 tetor rreth orës 08:30, aktivistët e saj kanë vërejtur se kandidatja për Kuvendin Komunal të Podujevës nga radhët e Lëvizës Vetëvendosje – Sebastiana Vokri me numër 12 në listë, ka shpërndarë material zgjedhor në hapësirë publike-trafo elektrike. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit politik LVV për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik LVV me datë 16.10.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i pranuar pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë lidhur me vendosjen e posterit në rrugë publike, mirëpo e njëjta ka theksuar se me kërkesën e kandidates Sebastiana Vokri, i njëjti poster ishte zhvendosur nga një person me emrin Sabri Murati, duke e vendosur në oborrin e shtëpisë së tij konkretisht në ormanin elektrik,

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se kandidatja për Kuvend Komunal të Podujevës nga radhët e subjektit politik LVV, Sebastiana Vokri ka shpërndarë material zgjedhor në rrugë publike në trafo stacion elektrik, veprim ky që është në kundërshtim 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakatave dhe posterave, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut etj.”*

Pretendimi si në përgjigje në ankesë, se nuk është kontestues fakti se në foto e cila iu është bashkangjitur ankesës vërehet posteri i kandidatës nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dhe se me kërkesën e kandidatës Sebastiana Vokri, i njëjti poster ishte zhvendosur, nuk arsyeton vendosjen e tij në kohë të fushatës, kur secili veprim i secilit kandidat për kryetar, apo kuvend komunal nga cilido subjekt politik hynë në kategorinë e veprimeve të ndaluara të Kodit të Mirësjelljes të cekur më lartë, e të cilat veprime sanksionohen. Qëllimi i sanksionimit të këtyre veprimeve ka të bëjë me ruajtjen e neutralitetit të pasurisë apo pronës publike, si pasuri e të gjithëve pa dallim.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik LVV, në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se kandidatja për Kuvend Komunal të Podujevës, nga radhët e këtij subjekti, Sebastiana Vokri, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se e njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës. Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes e vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik LVV, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, dhe të njëjtat ishin relevante dhe me ndikim për një vendimmarrje dhe se përmirësimi i shkeljes ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.619/2021 me datën 18.10.2021



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa komfor nenit 118 par 4 të LZP-së***